



PRAKTIKË

**MARKA TREGTARE NË KUNDËRSHTIM
ME POLITIKAT PUBLIKE OSE ME
PARIMET E PRANUARA TË MORALIT**

**SHTOJCË – BURIME LIGJORE
POTENCIALISHT TË RËNDËSISHME
PËR LIRINË E SHPREHJES**

SHTOJCË– BURIME LIGJORE POTENCIALISHT TË RËNDËSISHME PËR LIRINË E SHPREHJES

1	QËLLIMI I DOKUMENTIT	1
2	KUADRI LIGJOR	1
2.1	Legjislacioni i Bashkimit Evropian	1
2.2	Instrumente të tjera të lidhura	2
3	PRAKTIKA GJYQËSORE	3
3.1	Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë	3
3.1.1	Çështja “Fack Ju Göhte” ().....	3
3.1.2	Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Bobek për çështjen “Fack Ju Göhte” ().....	4
3.2	Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	4
3.2.1	Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë, Kërkesa nr. 69317/14, 30 janar 2018 ().....	5
3.2.2	Dor k. Rumanisë, Kërkesa nr. 55153/12, 25 gusht 2015 ()	8
3.2.3	Vajnai k. Hungarisë, Kërkesa nr. 33629/06, 8 korrik 2008 ().....	10

1 QËLLIMI I DOKUMENTIT

Dokumenti praktik për "marka tregtare në kundërshtim me politikën publike ose me parimet e pranuar të moralit" (PP14) nuk analizon si duhet kryer vlerësimi i ndikimit të lirisë së shprehjes në zbatimin e nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të Direktivës (BE) nr. 2015/2436 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2015 "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për markat tregtare" (DMT). Kjo çështje nuk është konsoliduar aktualisht në ligjin e BE-së për markat tregtare. Prandaj, kjo shtojcë është hartuar për të dhënë informacion për situatën deri më 7 shtator 2023 për burimet ligjore potencialisht të rëndësishme për zbatimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 11 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në lidhje me zbatimin e nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.

Seksioni 2 paraqet burimet ligjore të rëndësishme që duhen konsideruar në vlerësimin e kësaj arsyeje për refuzim.

Përveç kësaj, janë bërë kërkime për praktikën gjyqësore përkatëse, duke i dhënë vëmendje të veçantë udhëzuesit të botuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për zbatueshmërinë e përgjithshme të nenit 10 të KEDNj-së, i cili paraqet parimet kryesore në këtë fushë si dhe precedentët dhe praktikën gjyqësore përkatëse.

Në këtë aspekt, seksioni 3 i këtij dokumenti përmban ekstrakte nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë përzgjedhur duke u mbështetur te lidhja e tyre me objektin e Praktikës për "marka tregtare në kundërshtim me politikën publike ose me parimet e pranuar të moralit". Për një kuptim më të thellë të temës dhe të praktikës gjyqësore të përmendur më poshtë, këshillohet t'i referoheni udhëzuesit të lartpërmendur dhe të lexoni plotësisht praktikën e cituar në këtë shtojcë.

2 KUADRI LIGJOR

2.1 Legjislacioni i Bashkimit Evropian

- **Direktiva (BE) 2015/2436 "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare për markat tregtare" (DMT) ⁽¹⁾**

Deklamimi 27 i preambulës

... kjo Direktivë duhet të zbatohet në mënyrë që të sigurohet respektimi i plotë i të drejtave dhe lirive themelore, sidomos i lirisë së shprehjes.

- **Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (KDTHeBE) ⁽²⁾**

Neni 11 – Liria e shprehjes dhe informimit:

1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit si edhe për të marrë e për të dhënë informacion dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë.

2. Liria dhe pluralizmi i medias respektohen.

Neni 16 – Liria e sipërmarrjes:

Liria e sipërmarrjes njihet në përputhje me të drejtën e Bashkimit, të ligjeve dhe praktikave kombëtare.

⁽¹⁾ [Direktiva \(BE\) nr. 2015/2436 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 2015 "Për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare"](#)

⁽²⁾ [Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian](#)

Neni 17 – E drejta e pronës

2. Pronësia intelektuale mbrohet.

- **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) ⁽³⁾**

Neni 10

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit si edhe për të marrë e për të dhënë informacion dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, duke qenë se përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

2.2 Instrumente të tjera të lidhura

- Udhëzuesi për nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

[Udhëzuesi për nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – Liria e shprehjes](#) përditësohet rregullisht. Edhe pse nuk është detyrues për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ky udhëzues përmban një analizë hap pas hapi të lirisë së shprehjes në çështjet e shqyrtuara nga kjo gjykatë, si dhe shembuj të shumtë të kazuistikës dhe praktikës gjyqësore për të ilustruar interpretimin e saj në lëmenj/fusha të ndryshme, për të informuar profesionistët e drejtësisë.

Pikat më të rëndësishme të këtij udhëzuesi që lidhen me temat e praktikës CP14, konkretisht, me markat tregtare në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit janë këto më poshtë:

- | | |
|--------|---|
| I | Hyrje. |
| I(B) | Konsideratat e përgjithshme për nenin 10 në praktikën gjyqësore të Gjykatës. |
| II | Çështje specifike në vlerësimin e pranueshmërisë së çështjeve që kanë të bëjnë me nenin 10 të Konventës. |
| III | Shqyrtimi i çështjeve të lidhura me nenin 10 nga Gjykata: analizë hap pas hapi. |
| XI | Liria e shprehjes dhe synimet legjitime të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, parandalimi i prishjes së rendit ose krimeve. |
| XII | Liria e shprehjes dhe mbrojtja e shëndetit ose moralit. |
| XIV | Pluralizmi dhe liria e shprehjes. |
| XIV(F) | Pluralizmi dhe liria e shprehjes së pakicave. |

⁽³⁾ [Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#)

3 PRAKTIKA GJYQËSORE

3.1 Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

3.1.1 Çështja “Fack Ju Göhte” ⁽⁴⁾

Në këtë çështje, marka tregtare për të cilën ishte bërë aplikimi ishte shenja fjalë “Fack Ju Göhte”, shprehje e cila ishte titulli i një prej filmave më të suksesshëm në Gjermani në vitin 2013.

Kësaj shenje iu refuzua regjistrimi në bazë të nenit 7, paragrafi 1, germa “f” të Rregullores nr. 207/2009, lexuar në bashkëlidhje me nenin 7, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje. Apelimet e mëvonshme u refuzuan në mënyrë të njëpasnjëshme nga Bordi i Apelit të EUIPO-së dhe nga Gjykata e Përgjithshme. Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Përgjithshme dhe anuloi vendimin e EUIPO-së për refuzimin e markës tregtare.

Ky vendim është i rëndësishëm sepse pranon se liria e shprehjes duhet konsideruar, siç kërkohet në deklaminin 21 të Rregullores (BE) 2017/1001 “Për markat tregtare në BE” ⁽⁵⁾ (dhe në pajtim me deklaminin 27 të DMT-së).

Për këto përfundime u morën parasysh edhe elementë të kontekstit, si në citimet e mëposhtme të vendimit “Fack Ju Göhte”:

... suksesi i madh i komedisë me të njëjtin emër në publikun e gjerë gjermanishtfolës dhe fakti se titulli i saj duket se nuk ka shkaktuar kundërshti, si dhe fakti se është lejuar qasja e të rinjve tek kjo komedi dhe se Instituti Goethe – i cili është instituti i kulturës së Republikës Federale Gjermane, vepron në të gjithë botën dhe ka për detyrë, ndër të tjera, nxitjen e njohjes së gjuhës gjermane – e përdor atë për qëllime edukative.

6. Deklamimi 21 i Rregullores 2015/2424 shprehet:

(21) ... Përveç kësaj, Rregullorja duhet të zbatohet në atë mënyrë që të sigurohet respektimi i plotë i të drejtave dhe lirive themelore, **sidomos i lirisë së shprehjes**.

7. **Deklarimi 21 i Rregullores 2017/1001 riprodhon fjalë për fjalë** formulimin e deklamimit 21 të Rregullores **2015/2424** të paraqitur në paragrafin e mësipërm.

56. Në fund, duhet shtuar edhe, në kundërshtim me konstatimet e Gjykatës së Përgjithshme në paragrafin 29 të vendimit të apeluar, se “në fushën e artit, kulturës dhe letërsisë ekziston një shqetësim i vazhdueshëm për të mbrojtur lirinë e shprehjes, i cili nuk ekziston në fushën e markave tregtare”, kur zbatohet neni 7, paragrafi 1, germa “f” i Rregullores nr. 207/2009 duhet të merret parasysh liria e shprehjes, e mishëruar në nenin 11 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, ashtu siç EUIPO-ja e ka pranuar në seancë gjyqësore dhe siç e deklaroi Avokati i Përgjithshëm në pikat 47 deri 57 të këtij Opinioni. Për më tepër, ky konstatim mbështetet në deklaminin 21 të **Rregullores nr. 2015/2424**, e cila ndryshon Rregulloren nr. 207/2009 dhe në deklaminin 21 të **Rregullores 2017/1001**, të cilat **së bashku theksojnë shprehimisht** nevojën për të zbatuar këto rregullore në mënyrë të tillë që të sigurohet respektimi i plotë i të drejtave dhe lirive themelore, në mënyrë të veçantë liria e shprehjes.

⁽⁴⁾ 27.02.2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118.

⁽⁵⁾ [Rregullorja \(BE\) 2017/1001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 qershor 2017, “Për markat tregtare në Bashkimin Evropian”](#)

47. Liria e shprehjes luan vërtet rol në ligjin për markat tregtare.

48. Së pari, respekti për të drejtat themelore përbën kusht për ligjshmërinë e çdo mase të BE-së. Fushëveprimi i zbatimit të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (“Karta”) dhe **të drejtat themelore të garantuara aty shtrihet mbi çdo veprim ose mosveprim të institucioneve dhe organeve të BE-së. [...] Natyrisht kjo gjë vlen edhe për veprimet dhe mosveprimet e organeve të BE-së, të tilla si EUIPO-ja, në fushën e markave tregtare.**

49. Së dyti, natyra tregtare e një veprimtarie potenciale nuk është arsye për të kufizuar apo madje edhe për të përjashtuar mbrojtjen e të drejtave themelore. [...] Këtu mund të silllet në kujtesë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) është shprehur se **liria e shprehjes, e garantuar në nenin 10 të KEDNj-së, zbatohet pavarësisht nga lloji i mesazhit, duke përfshirë rastet ku kemi të bëjmë me publicitet tregtar.** [...] Ajo ka zbatuar lirinë e shprehjes veçanërisht në vlerësimin e kufizimeve që ka vendosur legjislacioni kombëtar mbi markat tregtare ose mbi format e tjera të publicitetit. [...]

50. Së treti, zbatueshmëria e lirisë së shprehjes në fushën e markave tregtare është konfirmuar shprehimisht në preambulën e Rregullores (BE) 2015/2424 e cila ndryshon Rregulloren nr. 207/2009 dhe është aktualisht e njohur në Rregulloren 2017/1001. [...].

51. Së katërti, më shumë si shënim shtesë, ky kuptim i ligjit është **konsekuent me praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës së Përgjithshme (24) dhe me praktikën e vendimmarrjes të vetë EUIPO-së.** [...].

52. Prandaj, **liria e shprehjes qartazi zbatohet në fushën e legjislacionit për markat tregtare.** ...

56. Për ta përmbledhur, edhe pse **nuk është synimi kryesor i legjislacionit për markat tregtare, liria e shprehjes është qartësisht e pranishme në këtë legjislacion.** Parë në këtë këndvështrim, pohimi në fjalë i Gjykatës së Përgjithshme në paragrafin 29 të arsyetimit të saj mbase ka pasur për synim të përçojë një ide pak më të ndryshme: jo se në legjislacionin për markat tregtare liria e shprehjes nuk ka fare rol, por se **në kontrast me fushat e artit, kulturës dhe letërsisë, pesha që duhet t’i jepet lirisë së shprehjes në fushën e legjislacionit markave tregtare mund të jetë deri diku e ndryshme, mbase pak më e lehtë në baraspeshimin në tërësi të drejtave dhe interesave të pranishme.**

57. ... edhe pse **në ushtrimin e përgjithshëm të baraspeshimit duhet të merren parasysh liria e shprehjes dhe të drejtat e tjera themelore potencialisht në lojë, mbrojtja e lirisë së shprehjes nuk është synimi parësor i mbrojtjes së markave tregtare.**

3.2 Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Ashtu siç shprehet udhëzuesi i lartpërmendur i GjEDNj-së, zbatueshmëria e nenit 10 të Konventës “përfshin edhe informacionin me natyrë tregtare”. Në këtë aspekt, ky dokument i referohet sidomos vendimeve të mëposhtme, edhe pse është e këshillueshme të konsultohet paralelisht *Udhëzuesi për nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut– Liria e shprehjes*:

⁽⁶⁾ [Opinionii i Avokatit të Përgjithshëm Bobek](#), dhënë më 2 korrik 2019, “Mbrojtja e markave tregtare dhe liria e shprehjes”, § 45-57.

3.2.1 *Sekmadienis Ltd. k. Lituanisë, Kërkesa nr. 69317/14, 30 janar 2018* ⁽⁷⁾

Kjo çështje i referohet një fushate publiciteti ku shfaqen modele që ngjajnë me figura fetare. Fushata përmban tekstet e mëposhtme: “MOTHER OF GOD, WHAT A DRESS”; “Jesus, Mary What A Style” dhe “JESUS, WHAT A JEANS”. Paditësi argumentonte se publiciteti ka degraduar simbolet fetare, ka fyer ndjenjat e besimtarëve dhe ka krijuar “rrezikun se shoqëria mund të humbë ndjesinë e nevojshme të shenjtërisë dhe respektin bazë për shpirtësinë”. Si rezultat, shoqëria tregtare u gjobit nga autoritetet lituaneze për shkak të faktit se reklamat që kishte shfaqur ishin konsideruar të ishin në kundërshtim me moralin publik.

Në këtë rast, liria e shprehjes u zbatua në reklama që kishin qëllim të pastër tregtar.

GJEDNj-ja doli në përfundimin se autoritetet lituaneze kishin shkelur të drejtën për liri të shprehjes sepse nuk kishin arritur të gjenin baraspeshën e duhur ndërmjet mbrojtjes së moralit publik dhe të drejtave të besimtarëve, nga njëra anë, dhe të drejtës së shoqërisë tregtare të paditësit për lirinë e shprehjes, nga ana tjetër.

2. Çmuarja e Gjykatës

(a) Nëse ka pasur ndërhyrje

[...]

(ii) Zbatim i parimeve të mësipërme në këtë çështje

66. Në këtë çështje, ndërhyrja e kundërshtuar bazohet në nenin 4 § 2(1) të Ligjit “Për reklamat” i cili ndalonte reklamat e publicitetit të “shkelnin moralin publik” (shih paragrafin 34 më lart). **Gjykata bie dakord me Qeverinë se koncepti i moralit publik është mjaftueshëm i gjerë dhe subjekt i ndryshimeve me kohën dhe, si rezultat, mund të mos jetë e mundur të ketë një përkufizim të qartë juridik** (shih paragrafin 53 më lart). **Ajo konsideron se nuk do të ishte realiste të pritej që legjislatura kombëtare të rendiste një listë shteruese të veprimeve që shkelin moralin publik** (shih, mutatis mutandis, Kudrevičius dhe të Tjerë kundër Lituanisë - Vendimi nr. 37553/05, § 113, GjEDNj 2015).

[...]

(d) Nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike

(i) Parimet e përgjithshme që lidhen me çështjen

70. **Gjykata ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike si dhe një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për vetëpërmbushjen e çdo individi. Nën rezervën e paragrafit 2 të nenit 10, ajo është e zbatueshme jo vetëm për “informacionin” ose “idetë” të cilat priten në mënyrë të pranueshme ose shihen si të padëmshme ose përgjithësisht me indiferencë, por edhe për ato që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë. Këto janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësisë, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Ashtu siç është sanksionuar në nenin 10, liria e shprehjes është subjekt i përjashtimeve të cilat, gjithsesi, duhet të interpretohen në mënyrë të rreptë dhe nevoja për kufizime duhet të argumentohet në mënyrë bindëse** (shih Von Hannover kundër Gjermanisë (nr. 2) [DhM], nr. 40660/08 dhe 60641/08, § 101, GjEDNj 2012; Bédat

⁽⁷⁾ [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22001-180506%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-180506%22]})

kundër Zvicrës [DhM], nr. 56925/08, § 48, GjEDNj 2016; dhe Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy, cituar më lart, § 124).

71. **Mbiemri “i nevojshëm”, brenda kuptimit të nenit 10 paragrafi 2, nënkupton një “nevojë shoqërore të ngutshme”. Shtetet Kontraktuese kanë njëfarë hapësire vlerësimi në çmuarjen nëse ekziston kjo nevojë, por ajo shkon dorë për dorë me mbikëqyrjen evropiane, e cila përfshin legjislacionin dhe vendimet që e zbatojnë atë, madje edhe ato të dhëna nga një gjykatë e pavarur. Prandaj Gjykata e ka fuqinë të japë vendimin përfundimtar nëse një “kufizim” është i pajtueshëm me lirinë e shprehjes ashtu siç mbrohet nga neni 10 (shih Mouvement raëlien suisse kundër Zvicrës [DhM], nr. 16354/06, § 48, GjEDNj 2012 (ekstrakte); Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 48876/08, § 100, GjEDNj 2013 (ekstrakte); dhe Bédat, cituar më lart, § 48).**

72. **Në ushtrimin e juridiksionit të saj mbikëqyrës, detyra e Gjykatës nuk është të marrë vendin e autoriteteve kompetente kombëtare, por t'i shqyrtojë nën parashikimet e nenit 10 vendimet që ato kanë dhënë, sipas fuqisë të tyre të vlerësimit. Kjo nuk do të thotë se mbikëqyrja kufizohet te verifikimi nëse Shteti i paditur ka ushtruar me arsye, me kujdes dhe në mirëbesim vetëgjykimin e tij; ajo që Gjykata duhet të bëjë është të shohë ndërhyrjen e ankimuar nën dritën e çështjes në tërësi dhe të përcaktojë nëse ka qenë “në përpjesëtim me interesin legjitim të ndjekur” dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar këtë ndërhyrje “kanë të bëjnë me të dhe janë të mjaftueshme”. Duke bërë këtë gjë, Gjykata duhet të përmbushë kërkesat e veta se autoritetet kombëtare kanë zbatuar standarde që janë në pajtim me parimet e mishëruara në nenin 10 dhe, për më tepër, ato janë mbështetur në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse (shih Mouvement raëlien Suisse, cituar më lart, § 48; Morice kundër Francës [DhM], nr. 29369/10, § 124, GjEDNj 2015; dhe Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe të Tjerë kundër Bosnjës dhe Hercegovinës [DhM], nr. 17224/11, § 75, 27 qershor 2017).**

73. **Gjykata më tej përsërit se gjerësia e hapësirës së vlerësimit të Shteteve Kontraktuese ndryshon në varësi të një numri faktorësh, ndër të cilët ka rëndësi të veçantë lloji i ligjëratës në fjalë. Në mënyrë të vazhdueshme është pohuar se neni 10, paragrafi 2 i Konventës ka pak fushëveprim për kufizimet mbi ligjëratat politike ose mbi debatet për çështjet me interes publik (shih Baka kundër Hungarisë [DhM], nr. 20261/12, § 159, GjEDNj 2016 dhe Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy, të cituara më lart, § 167). Megjithatë, Shtetet Kontraktuese kanë hapësirë më të gjerë vlerësimi kur rregullojnë lirinë e shprehjes në çështje të cilat mund të ofendojnë bindjet e thella personale brenda sferës së moralit ose të fesë në veçanti (shih Wingrove, cituar më lart, § 58 dhe Murphy kundër Irlandës, nr. 44179/98, § 67, GjEDNj 2003-IX (ekstrakte)). Po kështu, Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi në rregullimin e shprehjes në çështjet tregtare ose në ato të publicitetit (shih markt intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann kundër Gjermanisë, 20 nëntor 1989, § 33, Seria A nr. 165; Hertel, cituar më lart, § 47; dhe Mouvement raëlien Suisse, cituar më lart, § 61).**

74. **Gjykata së fundi përsërit se, ashtu siç e pranon shprehimisht paragrafi 2 i nenit 10, ushtrimi i lirisë së shprehjes sjell me vete detyra dhe përgjegjësi. Ndër to, në kontekstin e besimeve fetare, figuron kërkesa e përgjithshme për të siguruar gëzimin e qetë të të drejtave të garantuara në nenin 9 për mbajtësit e këtyre besimeve ku përfshihet detyra për të shmangur sa të jetë e mundur një**

shprehje e cila, sa i takon objekteve të kultit, fyen pa shkas të tjerët ose është profane (shih Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë, 20 shtator 1994, § 49, Seria A nr. 295-A; Murphy, cituar më lart, § 65; I.A. kundër Turqisë, nr. 42571/98, § 24, GjEDNj 2005-VIII; Giniewski kundër Francës, nr. 64016/00, § 43, GjEDNj 2006-I; dhe Klein, cituar më lart, § 47).

(ii) Zbatimi i parimeve të mësipërme në këtë çështje

[...]

78. Gjykata është shprehur më parë se nuk duhet përjashtuar se një shprehje, e cila në dukje nuk është fyese, mund të ketë ndikim fyes në disa rrethana (shih Murphy, cituar më lart, § 72). Prandaj u takonte gjykatave vendase të jepnin arsyet përkatëse dhe të mjaftueshme përse reklamën, të cilat në sytë e Gjykatës nuk ishin fyese në dukje, ishin gjithsesi në kundërshtim me moralin publik (shih, mutatis mutandis, VgT Verein gegen Tierfabriken kundër Zvicrës, nr. 24699/94, §§ 75-76, GjEDNj 2001-VI). **Gjykata gjithashtu vëren se, sipas parashtrimeve të Qeverisë, jo çdo përdorim i simboleve fetare në reklama do të shkelte nenin 4 § 2(1) i Ligjit për Reklamën** (shih paragrafin 53 më lart), **gjë që do të thotë se edhe ligji vendas kërkonte të paktën njëfarë shpjegimi përse forma e veçantë e shprehjes së zgjedhur nga shoqëria tregtare paditëse ishte në kundërshtim me moralin publik.**

[...]

81. Gjykata më tej vëren se disa prej autoriteteve i dhanë peshë të rëndësishme faktit se afërsisht njëqind individë ishin ankuar për reklamën (shih paragrafët 18 dhe 25 më lart). Nuk ka arsye për të dyshuar se këta individë duhet të jenë fyer me të vërtetë. Megjithatë, **Gjykata përsërit se liria e shprehjes shtrihet edhe mbi ide që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë** (shih referencat e dhëna në paragrafin 70 më lart). **Ajo përsërit edhe se në një shoqëri demokratike, ata që zgjedhin të ushtrojnë lirinë e tyre për të shfaqur fenë e tyre në mënyrë të arsyeshme nuk mund të presin që të përjashtohen nga të gjitha kritikët. Ata duhet të tolerojnë dhe pranojnë mohimin e besimeve të tyre fetare nga të tjerët, madje edhe përhapjen e doktrinave armiqësore me fenë e tyre nga të tjerët** (shih Otto-Preminger-Institut, § 47, dhe I.A. kundër Turqisë, § 28, të dy vendimet të cituara më lart; shih edhe qëndrimin e Komisionit të Venecias në paragrafin 49 më lart). Në këndvështrimin e Gjykatës, edhe pse reklamën kishin qëllim tregtar dhe nuk mund të thuhet se përbëjnë “kritikë” ndaj ideve fetare (shih paragrafin 76 më lart), parimet e zbatueshme janë gjithsesi të ngjashme (në lidhje me këtë shih në veçanti në paragrafin 18 më lart gjetjet e autoriteteve vendase se reklamën “inkurajuan një qëndrim të cekët kundrejt vlerave etike të besimit të krishterë”).

82. ... Në këndvështrimin e Gjykatës, nuk mund të merret me mend se kushdo që ka treguar se i përket fesë së krishterë me doemos do ta konsideronte fyese reklamën dhe Qeveria nuk ka paraqitur asnjë provë për të kundërtën. Megjithatë, edhe nëse marrim me mend se shumica e popullsisë lituaneze vërtet do ta konsideronte fyese reklamën, **Gjykata përsërit se do të ishte e papajtueshme me vlerat themeltare të Konventës nëse ushtrimi i të drejtave të Konventës nga një grup pakice t’i nënshtrohej pranimi të tij nga shumica. Nëse do të ishte kështu, e drejta e një grupi pakice, ndër të tjera, për lirinë e shprehjes do të kthehej në diçka vetëm teorike dhe jo praktike dhe efektive siç kërkohet nga**

Konventa (shih, mutatis mutandis, Barankevich kundër Ruisë, nr. 10519/03, § 31, 26 korrik 2007; Alekseyev kundër Ruisë, nr. 4916/07 dhe 2 të tjerë, § 81, 21 tetor 2010; dhe Bayev dhe të tjerë, cituar më lart, § 70).

83. Prandaj, **Gjykata del në përfundimin se autoritetet vendase nuk kishin arritur të gjenin baraspeshën e duhur ndërmjet, nga njëra anë, mbrojtjes së moralit publik dhe të drejtave të besimtarëve dhe, nga ana tjetër, të drejtës së shoqërisë tregtare të paditësit për lirinë e shprehjes.** Formulimi i vendimeve të tyre – si “në këtë rast loja ka shkuar shumë larg” (shih paragrafin 11 më lart), “respekti bazë për shpirtësinë po zhduket” (shih paragrafin 15 më lart), “përdorim i papërshtatshëm [i simboleve fetare] i ul ato [dhe] është në kundërshtim me moralin dhe normat etike të pranuar në mënyrë universale” (shih paragrafin 25 më lart) dhe “besimtarët reagojnë në mënyrë tejet të ndjeshme ndaj përdorimit të simboleve fetare ose figurave fetare në reklama” (shih paragrafët 11, 13, 15 dhe 18 më lart) – tregon se **autoritetet i dhanë epërsi absolute mbrojtjes së ndjenjave të besimtarëve, pa marrë parasysh në mënyrën e duhur të drejtën e shoqërisë tregtare të paditësit për liri të shprehjes.**

84. Prandaj aty ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

3.2.2 Dor k. Rumanisë, Kërkesa nr. 55153/12, 25 gusht 2015 ⁽⁸⁾

Kjo çështje i referohej aplikimit të shenjës “KRYQ” për shërbimet që i përkisnin Klasave 36, 41, 42 dhe 45 përpara Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Rumanisë. Zyra e refuzoi regjistrimin me arsyen e rendit dhe moralit publik, duke konsideruar se simbolet fetare mund të përdoren vetëm në lidhje me veprimtaritë fetare dhe nga persona të autorizuar. Ky nuk ishte rasti për shenjën në fjalë, duke u nisur nga shërbimet për të cilat po kërkohej shenja.

GjEDNj-ja vërejti se çështja nuk ka të bëjë me shfaqjen e lirisë së mendimit, ndërgjegjes ose fesë së paditësit, por me përdorimin tregtar të një marke tregtare. Ajo përfundoi, ndër të tjera, se refuzimi i aplikimit për markën tregtare përkon me një ndërhyrje në të drejtën për liri të shprehjes së paditësit. Kjo ndërhyrje shkel nenin 10 me përjashtim të rastit kur është “e parashikuar me ligj”, mbron një interes legjitim sipas nenit 10, paragrafi 2, të KEDNj-së dhe është “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Në ligj

38. Paditësi pretendon se zgjedhja e emrit dhe përfaqësimit grafik të shenjës “KRYQ” është brenda fushëveprimit të lirisë së tij të mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar dhe se me refuzimin për të regjistruar shenjën autoritetet vendase kanë shkelur lirinë e tij të shprehjes.

39. Gjykata vëren se kjo çështje nuk ka të bëjë me shfaqjen e lirisë së mendimit, ndërgjegjes ose fesë së paditësit, por me përdorimin tregtar të një marke tregtare. Në këto rrethana, Gjykata e konsideron me vend ta shqyrtojë padinë vetëm nën dritën e nenit 10 të Konventës. Kjo dispozitë shprehet si më poshtë:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit si edhe për të marrë e për të dhënë informacion dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë ...

2. Ushtrimi i këtyre lirive, i cili përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u

⁽⁸⁾ <https://hudoc.echr.coe.int/eng/#f{%22languageisocode%22:%22FRE%22,%22appno%22:%2255153/12%22,%22documentcollectionid%22:%22ADMISSIBILITY%22,%22itemid%22:%22001-157422%22}>

nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

A. Nëse ka pasur ndërhyrje në lirinë e shprehjes së paditësit

41. Gjykata sjell në kujtesë se publiciteti është një mjet që qytetarët të mësojnë për karakteristikat e shërbimeve dhe mallrave që u ofrohen (Casado Coca kundër Spanjës, vendim i datës 24 shkurt 1994, Seria A, nr. 285-A, f. 13, § 51).

42. Në këtë çështje, duke zbatuar regjistrimin e markës tregtare “KRYQ”, paditësi synonte t'i bënte të ditur në publik shërbimet që ai dëshironte të ofronte me atë markë, duke e dalluar veten nga sipërmarrjet e tjera konkurrense. **Në atë kontekst, marka e kundërshtuar ishte element i rëndësishëm i publicitetit dhe strategjisë së tij tregtare.**

43. **Duke sjellë në kujtesë se neni 10 i Konventës garanton lirinë e shprehjes për “cilindo”, pavarësisht llojit të mesazhit që përçohet** (shih Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës, 28 mars 1990, § 55, Seritë A nr. 173), **edhe kur publiciteti është tregtar** (shih Casado Coca, cituar më lart, §§ 36-37) **ose kur synimi është për të nxjerrë fitime** (shih Autronic AG kundër Zvicrës, 22 maj 1990, § 47, Seria A nr. 178), **Gjykata konsideron se, nisur nga natyra publicitare e markës, kërkesa e paditësit hyn në fushëveprimin e nenit 10, paragrafi 1, të Konventës.**

44. **Prandaj, refuzimi i aplikimit është ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga paditësi. Kjo ndërhyrje shkel nenin 10, me përjashtim të rastit kur është “parashikuar me ligj”, mbron një qëllim ose qëllime të ligjshme sipas paragrafit 2 të nenit 10 dhe është “e nevojshme” në një shoqëri demokratike.**

B. Nëse është parashikuar me ligj kjo ndërhyrje

46. Prandaj Gjykata konsideron se ndërhyrja në fjalë ishte “parashikuar me ligj”, konkretisht nga neni 5, germa “f” e ligjit nr. 84/1998.

C. Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm

47. Gjykata konsideron se ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, konkretisht mbrojtjen e publikut nga praktikat tregtare mashtruese dhe përputhshmërinë me ligjin për konsumatorin. Ajo vazhdon se masa në fjalë ka ndjekur qëllimin e ligjshëm “të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve” dhe “të parandalimit të veprave penale” brenda kuptimit të paragrafit 2 të nenit 10.

D. Nëse ndërhyrja e supozuar ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike

48. Në Dhomën e Madhe të gjykimit në çështjen Mouvement raëlien suisse kundër Zvicrës [DhM], nr. 16354/06, §§ 59-63, GjEDNj 2012 (ekstrakte), Gjykata rikujtoi praktikën e saj gjyqësore për kufizimet që mund t'i vihen shprehjes që më shumë ngjan me shprehjen tregtare sesa me atë politike.

49. Në këto çështje, autoritetet kombëtare, në parim, janë në një pozitë më të mirë sesa gjykata ndërkombëtare për të vendosur nëse një “kufizim” ose “sanksion” është “i nevojshëm” për të përmbushur qëllimin e ligjshëm që ato po ndjekin, falë kontakteve të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme që ato kanë me popullsinë e vendit (Müller dhe të Tjerët kundër Zvicrës, 24 maj 1988, § 35, Seria A nr.133).

50. Në ushtrimin e juridiksionit të saj mbikëqyrës, Gjykata nuk ka për detyrë të marrë vendin e gjykatave kombëtare, por ka për detyrë të verifikojë, në dritën e çështjes në tërësi, nëse vendimet që këto gjykata kanë marrë me fuqinë e tyre vetëgjykimore janë në pajtim me dispozitat e Konventës ku ato janë mbështetur (Axel Springer AG kundër Gjermanisë [DhM], nr. 39954/08, § 86, 7 shkurt 2012).

51. Fushëveprimi i hapësirës së vlerësimit që kanë Shtetet Kontraktuese në vlerësimin e nevojës dhe shtrirjes së ndërhyrjes është më e madhe kur ato rregullojnë lirinë e shprehjes në fusha të cilat kanë gjasë të fyejnë bindjet e thella personale me natyrë morale ose, më në veçanti, me natyrë fetare (Murphy kundër Irlandës, nr. 44179/98, § 67, GjEDNj 2003-IX (ekstrakte)). Shtetet kanë gjithashtu hapësirë të gjerë vlerësimi në rregullimin e shprehjes tregtare dhe publicitare (shih markt intern Verlag GmbH dhe Klaus Beermann kundër Gjermanisë, 20 nëntor 1989, § 33, Seria A nr. 165; Casado Coca, cituar më lart, § 50).

52. Publiciteti mund të jetë subjekt i kufizimeve të parashikuara për të parandaluar, ndër të tjera, konkurrencën e pandershme dhe publicitetin mashtrues. Në disa kontekste, edhe publikimi i mesazheve të reklamave objektive dhe të sinqerta mund të bëhet subjekt i kufizimesh, të cilat synojnë respektimin e të drejtave të të tjerëve ose mbështeten në veçantitë e një veprimtarie tregtare ose profesioni të caktuar (Casado Coca, cituar më lart, § 51).

53. Në këtë çështje, Gjykata vëre se paditësi nuk e ka provuar me asnjë mënyrë ekzistencën e lidhjes ndërmjet shërbimeve, sidomos shërbimeve ligjore, të cilat ai synonte t’ia ofronte publikut nën markën e kundërshtuar dhe me simbolin fetar të kryqit. Përkundrazi, ai u mjaftua me pohimin se kjo zgjedhje binte në fushëveprimin e lirisë së tij të mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar si dhe brenda fushëveprimit të lirisë së tij të shprehjes.

54. Në këto rrethana, Gjykata nuk sheh arsye për të konsideruar se gjykatat vendase tejkaluan hapësirën e tyre të vlerësimit kur konstatuan se kishte një rrezik për ta mashtruar publikun dhe kur ato i dhanë përparësi së drejtës së publikut për t’u mbrojtur nga reklammat e mundshme mashtruese dhe jo së drejtës së paditësit për lirinë e shprehjes.

56. Në dritën e këtyre faktorëve dhe duke pasur parasysh hapësirën veçanërisht të gjerë të vlerësimit që disponojnë autoritetet vendase, Gjykata konsideron se ndërhyrja në fjalë nuk është në shpërpjesëtim me synimin e ndjekur.

3.2.3 Vajnai k. Hungarisë, Kërkesa nr. 33629/06, 8 korrik 2008 ⁽⁹⁾

Kjo çështje ka të bëjë me përdorimin e një simboli, konkretisht një yll i kuq me pesë cepa, nga Zëvendës-presidenti i Partisë së Punëtorëve të Hungarisë, gjatë një demonstrate të ligjshme. Nisur nga përdorimi i dikurshëm i simbolit dhe kuptimi i tij publik, Gjykata Qendrore e Rrethit të Pestit e dënoi paditësin

⁽⁹⁾ [https://hudoc.echr.coe.int/eng/#{%22itemid%22:\[%22001-87404%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng/#{%22itemid%22:[%22001-87404%22]})

në përputhje me Kodin Penal të Hungarisë. Gjykata hungareze e konsideroi fyerje veprimin e mbajtjes së yllit të kuq me pesë cepa për shkak të përdorimit të një simboli totalitar.

GjEDNJ-ja vërejtë se ylli i kuq nuk mund të kuptohet vetëm si përfaqësim ekskluziv i rregullave totalitare komuniste, sepse ai simbolizon edhe lëvizjen ndërkombëtare të punëtorëve. Gjykata nënvizoi gjithashtu se paditësi mbajti simbolin e yllit të kuq gjatë një demonstrate të organizuar në mënyrë të ligjshme pa pasur si qëllim të sfidonte shtetin e së drejtës. GjEDNJ-ja doli në përfundimin se është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet një shprehjeje tronditëse dhe fyese nga ajo që humbet mbrojtjen e nenit 10 të KEDNJ-së, prandaj, ndalimi i përdorimit të këtij simboli do të ishte shumë i gjerë duke konsideruar kuptimet e shumta të yllit të kuq.

A. Nëse ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut.

52. Gjykata është e vëmendshme për faktin se shkeljet famëkeqe masive të të drejtave të njeriut gjatë komunizmit e diskredituan vlerën simbolike të yllit të kuq. Megjithatë, në këndvështrimin e Gjykatës, simboli nuk mund të kuptohet se përfaqëson vetëm sundimin komunist totalitar, siç e ka pohuar në mënyrë të nënkuptuar Qeveria (shih paragrafin 40 më lart). Është e qartë se ky yll simbolizon edhe lëvizjen punëtore ndërkombëtare, e cila lufton për një shoqëri më të drejtë, si dhe disa parti politike të ligjshme të cilat janë aktive në Shtete Anëtare të ndryshme.

B. Nëse paditësi ka sfiduar shtetin e së drejtës duke përdorur simbolin.

53. Për më tepër, Gjykata vëren se Qeveria nuk ka treguar se mbajtja e yllit të kuq në mënyrë ekskluzive do të thotë identifikim me idetë totalitare, sidomos kur shihet nën dritën e faktit se paditësi e bëri këtë në një demonstratë të organizuar ligjërisht dhe paqësisht në cilësinë e tij si zëvendës-president i një partie politike të majtë, pa qëllime të njohura për të marrë pjesë në jetën politike hungareze duke sfiduar shtetin e së drejtës. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se vetëm duke bërë një shqyrtim të kujdesshëm të kontekstit në të cilin shfaqen fjalët fyese mund të bëhet një dallim kuptimplotë ndërmjet gjuhës tronditëse dhe fyese, e cila mbrohet nga neni 10 i Konventës dhe e cila humbet të drejtën e saj për tolerancë në një shoqëri demokratike.

C. Nëse ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

54. Prandaj Gjykata konsideron se ky ndalim është shumë i gjerë nisur nga kuptimet e shumta të yllit të kuq. Ndalimi mund të ngërthejë veprimtari dhe ide që qartazi i përkasin atyre që mbrohen nga neni 10 dhe nuk ka mënyrë të kënaqshme për të veçuar kuptimet e ndryshme të simbolit të akuzuar. Në fakt, ligji përkatës hungarez nuk përpiqet ta bëjë këtë gjë. Për më tepër, edhe nëse kanë ekzistuar dallime të tilla, mund të kenë lindur paqartësi të cilat kanë sjellë efekte shkurajuese të liria e shprehjes dhe vetëcensurimi.

55. Sa i takon synimit për të parandaluar prishjen e rendit, Gjykata vëren se Qeveria nuk i është referuar asnjë shembulli ku të ketë lindur në Hungari një rrezik aktual ose edhe i largët për prishje të rendit nga shfaqja në publik e yllit të kuq. Në këndvështrimin e Gjykatës, frenimi i një rreziku të thjeshtë spekulativ, si masë parandaluese për mbrojtjen e demokracisë, nuk mund të shihet si “nevojë e ngutshme shoqërore”. Gjithsesi, përveç ndalimit në fjalë, ka disa vepra penale të sanksionuara nga ligji hungarez të cilat synojnë shtypjen e turbullirave, edhe nëse ato do të provokoheshin nga përdorimi i yllit të kuq (shih paragrafin 15 më lart).